



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Proglobal" Sh.P.K. të datës 02.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajisje personale bateri rimbushëse" me nr. të prokurimit 616-25-1699-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Proglobal" Sh.P.K. të datës 02.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajisje personale bateri rimbushëse" me nr. të prokurimit 616-25-1699-1-2-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn** në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Proglobal" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pajisje personale bateri rimbushëse" me nr. të prokurimit 616-25-1699-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “Me qellim që te respektohet LPP dhe te mos ketë diskriminim, ashtu që te trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe te ketë mundësi të barabartë pjesëmarrje për të gjithë OE të interesuar duhet të aplikohen ndryshime në Specifikimet Teknike – ashtu që të jenë neutrale dhe tolerante. Pjesë e Specifikimit teknik në Dosjen e tenderit, Duhet të jete: Dimensionet: Gjatësia: 16.5-18 cm; Gjerësia: 6.5-7.5cm; Diametri: 6-7cm Pesha: max. 400gr Candela: min. 40000 Fuqia e rrezeve të dritës min. 200 lumena Niveli i mbrojtjes ndaj ujit dhe pluhurit, min. IP67 Dimensionet ku mbahet bateria nuk duhet të jenë pjesë e specifikimit teknik. Nuk janë të rendesishme sepse dimensionet e baterise në tansi janë të mjaftueshme. Si të tilla nuk duhet të përfshihen në specifikimin teknik”.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përcaktimeve të njësisë kërkuese. Për më tepër është konstatuar se të gjitha specifikat teknike kanë tolerancë të mjaftueshme dhe si të tilla janë në përputhje të plotë me nenin 7 lidhur me nenin 27 dhe 28 të LPP. Në anën tjetër nuk është prezantuar asnjë dëshmi apo argument sipas të cilit do të mund të konfirmoj se ST aktuale janë në kundërshtim me LPP dhe se duhet të vendosen specifikat e propozuara nga parashtruesi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.